



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1202/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besim Hoti, anëtarë i kryesisë së degës së LDK-së në Klinë, paraqitur kundër Qendrës të Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Besim Hoti anëtarë i kryesisë së degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Klinë

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:10 nga Besim Hoti anëtarë i kryesisë së degës së LDK-së në Klinë, ku ka pretenduar se subjekti politik LDK është dëmtuar me një ulëse në Kuvendin Komunal të Klinës. Pretendimin e tij e mbështet duke u bazuar se ndarja e mandateve bëhet në përpjesëtim në përqindjen e votave të përgjithshme në ulëset e kuvendit. Ankuesi kërkon që t'i kthehet ulësja e gjashtë (6), thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e anëtarit të kryesisë së degës së LDK-së në Klinë, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe nuk kanë mbështetje ligjore. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1202/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.